



Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-64510

Dt. 11.09.2024

P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR K – PRIZREN, me kërkesën e **Zinije, Sherif, Muhamed Sallashi, Sevdije Dida, Kadensa Karahasan dhe Sevilay Ljuma** me banim në rrugën “**Ersan Mazreku**” nr.21 me numër të kërkesës 04-353/01-64510 të datës 28.05.2024 në bazë të nenit 3. pika 1.11 si dhe nenit 5 alineja 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 alineja – 1 pika 1.5 dhe nenit 15 alineja 1 pika 1.1 dhe neni 19 alineja 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të dhe neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Pergjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **LEJOHET: Zinije, Sherif, Muhamed Sallashi, Sevdije Dida, Kadensa Karahasan dhe Sevilay Ljuma** me banim në rrugën “**Ersan Mazreku**” nr.21 në zhvillimin e punimeve: **Ndrimin e kulmit – nga kulmi i pjerrët në kulëm të rrafshët** të objektit me numër **O-71813068-2452-0 ZK Prizren**, e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-07238-21**, e cila është e identifikuar sipas kopjes së planit e vërtetuar nga ana e këtij shërbimi.
- II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit **të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese N.P.N.C. “Agoni”**
- III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi, zgjerimi në gabarit dhe në etazhitet të objektit.
- IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.
- V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Zinije, Sherif, Muhamed Sallashi, Sevdije Dida, Kadensa Karahasan dhe Sevilay Ljuma** me banim në rrugën “**Ersan Mazreku**” nr.21 me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për **Ndrimin e kulmit – nga kulmi i pjerrët në kulm të rrafshët të objektit-Shtëpi individuale me nr të objektit O-71813068-2452-0 e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër P-71813068-07238-21, ZK Prizren.**

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:


Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.

DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur. dip.

